


**RAPORTI I ADMINISTRATORËVE**  
**DHE**  
**PROJEKT-MARRËVESHJA E BASHKIMIT ME PËRTHITHJE**  
**TË SHOQËRISË PËRTHITHËSE GREEN COAST SH.P.K**  
**ME**  
**SHOQËRINË E PËRTHITHUR GREEN COAST 2 SH.P.K.**

\*\*\*\*\*

**Duke parashtruar se:**

- A. Shoqëria BALFIN SH.P.K, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njësia bashkiake nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K, zotëron 100% të kapitalit në shoqërinë :
- (i) GREEN COAST SH.P.K, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njësia Bashkiake nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D, përfaqësuar nga administratori Znj. Çeljeta Apostol, shtetase shqiptare, lindur më 24.04.1973, në Laç, Krujë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. BE7466969, dhe me nr. personal H35424057N, me kapital të regjistruar me vlerë 2,562,416,988 LEKE; dhe
- (ii) GREEN COAST 2 SH.P.K. , shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizaur sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, kati 4, apartamenti 26 regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L72115009L, përfaqësuar nga Administratori Znj. Çeljeta Apostol, shtetase shqiptare, lindur në Laç, në datën 23.09.1975, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. BE7466969 dhe me numër personal H35424057N, me kapital të regjistruar me vlerë 96,15,840 LEKE;
- B. të gjitha shoqëritë, si më sipër përcaktuar, janë shoqëri aktive, nuk janë në likuidim apo në falimentim dhe nuk janë aktualisht subjekt i ndonjë procedure likuidimi të detyrueshëm apo vullnetar;
- C. qëllimi i këtyre shoqërive është të realizojnë operacionin e bashkimit me përthithjen mes GREEN COAST SH.P.K. shoqërisë perthithëse dhe GREEN COAST 2 SH.P.K. shoqëria që do të përthithet;
- D. operacioni në fjalë synon bashkimin me përthithje të shoqërisë përthithëse me shoqërisë se përthithur në një ndërmarrje të vetme dhe, rrjedhimisht, reduktimin e kostove të administrimit dhe optimizmin në tërësi të pasurive/mjeteve të shoqërive të përfshira në këtë operacion;



*duke qenë se ekzistojnë këto kushte dhe mbështetur ne Raportin e Audituesit te Pavarur Venis Audit & Financë shpk (NUIS L1200500L) me date 28.10.2020*, administratori i shoqërisë GREEN COAST SH.P.K dhe GREEN COAST 2 SH.P.K paraqesin këtë raport bashkimi me përthithje (si edhe projekt-marrëveshjen e bashkimit me përthithje bashkëlidhur me të).

#### 1. SHOQËRITË PJESËMARRËSE NË BASHKIM

- Shoqëria përthithëse:

GREEN COAST SH.P.K., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njësia Bashkiake nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D, përfaqësuar nga administratori Znj. Çeljeta Apostol, me:

*"Objekti i parësorë i veprimtarisë së shoqërisë Shoqërisë është projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim e një kompleksi turistik, një strukture hoteliere dhe e objekteve turistike sezonale në Palasë. Shitja e objekteve me destinacion rezidencial veror dhe/ose administrimi i tyre, si edhe ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit në zonën e Palacës, si dhe çdo veprimtari tjetër plotësuese, që lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e sipërpërmendur."* (përcaktohet në vijim si, "**Shoqëria Përthithëse**")

- Shoqëria e përthithur:

GREEN COAST 2 SH.P.K. , shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizaur sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, kati 4, apartamenti 26 regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L72115009L, përfaqësuar nga Administratori Znj. Çeljeta Apostol, me objekt aktiviteti, ndër të tjera,:

*"Projektimi, Ndërtimi, vënia në shfrytëzim, administrimi, mirëmbajtja, menaxhimi, operimi i Resorteve Turistike, Enklavave të Zhvillimit të Objekteve dhe Fshatrave Turistike dhe Njësive të Hotelierisë. Ndërtimi i objekteve turistike të përhershme dhe sezonale. Ndërtimi i objekteve, banesave kolektive dhe individuale, apartamenteve dhe vilave individuale. Menaxhimi i hoteleve të çdo niveli sipas legjislacionit. Menaxhimi i pronave të veta dhe private për klientë të huaj dhe vendas sipas konceptit, «Property Share (Timeshare)». Tregtim i artikujve të ndryshëm. Import, eksporti, shitja me shumicë dhe pakicë e paisjeve elektrike, elektronike, lëndë të parë për industrinë, materiale ndërtimi e hidrosanitare, pajisje zytrash, kancelari, pjesë këmbimi auto e makineri të çdo lloji, pajisje teknologjike etj. Shitja, blerja, dhënia me qira e pasurive të paluajtshme. Transport i mallrave dhe udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit. Zhvillimi i udhëtimeve turistike dhe shitja e paketave turistike"*, (në vijim përcaktuar si "**Shoqëria e Përthithur**").

(Shoqëria Përthithëse dhe Shoqëria e Përthithur janë në vijim të përcaktuara sëbashku si "**Shoqëritë Pjesëmarrëse në Bashkim**")



## 2. GJENDJA EKONOMIKE PËRKATESE

Në përputhje me parashikimet e nenit 216, paragrafi 3, i Ligjit nr. 9901, me datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (në vijim "Ligji Tregtar"), i bashkëlidhen këtij akti dokumenti i bilancit kontabël/ të ardhurat e shpenzimet e Shoqërisë Përthithëse (GREEN COAST SH.P.K.) dhe i Shoqërisë së Përthithur (GREEN COAST 2 SH.P.K.) me datë 31.08.2020 dhe respektivisht bilancet ushtrimore të Shoqërive Pjesëmarrëse në Bashkim të aprovuara nga asambltetë e ortakëve të secilës shoqëri për vitin 2017, 2018 dhe 2019.

## 3. STATUTI

Me kryerjen e operacionit të bashkimit sipas kësaj projekt marrëveshjeje, nuk do të jetë e nevojshme të modifikohet statuti i Shoqërisë Përthithëse.

## 4. RAPORTI I KËMBIMIT DHE RAKORDIMI I SHUMAVE TË PAGUESHME NË PARA

Ky transaksion po kryhet nga shoqëri që kanë lidhje të pronësisë së kapitalit ndërmjet tyre, në rrethanat e mëposhtme:

- i. BALFIN SH.P.K. zotëron 100% të kapitalit të GREEN COAST SH.P.K.;
- ii. BALFIN SH.P.K. zotëron 100% të kapitalit të GREEN COAST 2 SH.P.K.

Në përputhje me natyrën e transaksionit dhe në kushtet që shoqëria BALFIN SH.P.K. është zotëruese e 100% të kapitalit të shoqërisë GREEN COAST 2 SH.P.K., e cila po ashtu është zotëruese e 100% të kapitalit të shoqërisë GREEN COAST SH.P.K., pra ortak i vetëm i këtyre shoqërive, nuk është e zbatueshme dispozita për për kalkulimin e raportit të këmbimit të kuotave të shoqërive të përfshira në bashkim, me qëllim pagimin e ortakëve të shoqërisë që përthithet, pasi nuk është kombinim biznesi, GREEN COAST SH.P.K. ishte dhe mbetet në pronësi të BALFIN SH.P.K.

Gjithashtu, bashkëlidhet në këtë projekt marrëveshjeje, gjendet raporti i raportit të ekspertit të pavarur të licencuar Venis Audit & Financë shpk (NUIS L1200500L) me date 28.10.2020, i parashikuar në 217 të Ligjit Tregtar.

## 5. KUSHTET E NDARJES SË KUOTAVE, TË DREJTAT QË RRJEDHIN NGA KUOTAT E SHOQËRISË PËRTHITHËSE/ E DREJTA E PJESËMARRJES NË FITIME

Në përputhje me natyrën e transaksionit dhe në kushtet që:

- kapitali i regjistruar i Shoqërisë Përthithëse (GREEN COAST SH.P.K.), përbehet nga 1 kuotë me vlerë 2,562,416,988 LEKE, e zotëruar në masën 100% nga ortaku i vetëm BALFIN SH.P.K.;



- kapitali i regjistruar i Shoqërisë së Përthithur (GREEN COAST 2 SH.P.K.), përbehet nga 1 kuotë me vlerë 96,165,840 LEKE, e zotëruar në masën 100% nga ortakut i vetëm BALFIN SH.P.K.;
- Shoqëria Përthithëse dhe Shoqëria e Përthithur janë shoqëri të kontrolluara drejtëpërdrejtë nga BALFIN SH.P.K.

sugjerohet që investimin i kryer nga ortakut i vetëm BALFIN SH.P.K. në Shoqërinë e Përthithur (GREEN COAST 2 SH.P.K.) të njihet dhe transferohet në Shoqërinë Përthithëse (GREEN COAST SH.P.K.) në formën e zmadhimit të kapitalit.

Në këtë mënyrë, vlera e kapitalit të Shoqërisë Përthithëse do të rritet deri në vlerën e kapitalit ekzistues të Shoqërisë së Përthithur, kapital i cili i përket ortakut fundor shoqërisë BALFIN SH.P.K.. Pra, vlera e regjistruar e kapitalit të Shoqërisë Përthithëse (GREEN COAST SH.P.K.) nga 2,562,416,988 LEKE pas bashkimit do të bëhet 2,658,582,828 LEKE. Struktura e ortakërisë nuk do të ndryshojë do të mbetet 100% në pronësi të shoqërisë BALFIN SH.P.K..

Bashkimi me përthithje nuk do të ketë për pasojë emetimin dhe dhënien e një kuote të re në Shoqërinë Përthithëse në këmbim të kuotës të Shoqërisë së Përthithur. Kuota e Shoqërisë së Përthithur do të anulohet.

#### 6. EFEKTET E BASHKIMIT

Bashkimi do të perfeksionohet (shpalos efektet) me ekzekutimin e regjistrimit të fundit sipas parashikimeve të nenit 220, paragrafi 1, Ligjit Tregtar.

Për efekt të bashkimit Shoqëria Përthithëse (GREEN COAST SH.P.K.) do të përfshijë në pasurinë e saj të gjithë zërat aktivë dhe pasiv të Shoqërisë së Përthithur (GREEN COAST 2 SH.P.K.), të zotëruar prej saj në bazë të pasqyrave financiare të datës 31.08.2020. Për më tepër, Shoqëria Përthithëse (GREEN COAST SH.P.K.) do të zëvendësojë Shoqërinë e Përthithur (GREEN COAST 2 SH.P.K.) në pronësinë e aseteve në tërësi, në të drejtat, angazhimet e marra prej saj dhe detyrimet e cilitdo lloji qofshin ato, kjo në përputhje me nenin 220, paragrafi 3, Ligji Tregtar.

Për qëllime kontabiliteti dhe fiskale, operacionet e Shoqërive të Përthithura do të hidhen/shënohen në bilancin e Shoqërisë Përthithëse duke nisur nga data 31.08.2020.

Me regjistrimin e bashkimit me përthithje pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Shoqëria e Përthithur (GREEN COAST 2 SH.P.K.), të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, pa kaluar në procesin e likuidimit. Personaliteti juridik do të vazhdojë të ketë vetëm Shoqëria Përthithëse GREEN COAST SH.P.K..



#### **7. TRATIMI I REZERVUAR PËR KATEGORI TË VEÇANTA ORTAKËSH**

Në asnjërën prej Shoqërive Pjesëmarrëse në Bashkim nuk ekzistojnë kategori të veçanta ortakësh zotërues titujsh të ndryshëm nga kuotat e shoqërisë apo të drejtash apo çdo mase tjetër në favor të tyre.

#### **8. PËRPARËSI TË PROPOZUARA NË FAVOR TË ADMINISTRATORËVE TË SHOQËRIVE PJESËMARRËSE NË BASHKIM**

Operacioni i propozuar nuk parashikon përparësi në favor të administratorëve të Shoqërive Pjesëmarrëse në Bashkim. Administratori në detyrë i Shoqërisë së Përthithur do të jap dorëheqjen në datën e regjistrimit të bashimit me përthithje në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sikurse parashikon neni 220, pika 3, e Ligjit Tregtar.

#### **9. TRATIMI I PUNËMARRËSEVE TË SHOQËRIVE PJESËMARRËSE NË BASHKIM**

Shoqëria e Përthithur ka vetëm një personel në cilësinë e Administratorit .

#### **10. TRATIMI I KREDITORËVE EVENTUAL TË SHOQËRIVE PJESËMARRËSE NË BASHKIM**

Për efekt të bashimit, Shoqëria Përthithëse (GREEN COAST SH.P.K.) fiton (merr përsipër) të gjitha aktivët dhe pasivët e Shoqërisë së Përthithura (GREEN COAST 2 SH.P.K.) duke pasuar atë në të gjitha raportet e krijuara prej saj dhe duke ofruar garanci më të larta kundrejt të tretëve. Dhe në fakt, siç deduktohet nga dokumentacioni bashkëlidhur, Shoqëria Përthithëse ka një gjendje ekonomike dhe financiare me të konsoliduar sesa Shoqëria e Përthithura.

Pavarësisht nga sa më sipër, Shoqëritë Pjesëmarrëse në Bashkim dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë marrin përsipër t'i japin çdo kreditori eventual që, brenda afateve të përcaktuara në nenin 221 të Ligjit Tregtar, ngre cilindo pretendime, të gjitha garancitë e parashikuara në nenin 221, paragrafi 1, Ligjit Tregtar.

\*\*\*\*\*

Do të konsiderohen pjesë e kësaj Projekt marrëveshje Bashkimi ndryshimet, integrimet dhe përditësimet edhe numerike, eventualisht të kërkuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit ("QKR") apo nga kontrollet ligjore apo ato që do të diktohen nga asambleja e jashtëzakonshme e ortakëve që marrin vendimin për bashkim të cilat nuk ndikojnë mbi të drejtat e ortakëve apo të tretëve.

\*\*\*\*\*

Kësaj Projekt marrëveshje Bashkimi i bashkëlidhen:





- Shtojca A** – Bilanci Kontabël / Të ardhurat e Shpenzimet GREEN COAST SH.P.K. më 31 gusht 2020 (ne CD);
- Shtojca B** – Bilanci Kontabël / Të ardhurat e Shpenzimet GREEN COAST 2 SH.P.K. më 31 gusht 2020 (ne CD);
- Shtojca C** – Pasqyrat Financiare GREEN COAST SH.P.K. më datë 31.12.2017, 31.12.2018 dhe 31.12.2019 (ne CD);
- Shtojca D** – Pasqyrat Financiare GREEN COAST 2 SH.P.K. më datë 31.12.2017, 31.12.2018 dhe 31.12.2019 (ne CD);
- Shtojca E** – Projekt-Marreveshja e Bashkimit me Perthithje mes Shoqërisë Perthithëse GREEN COAST SH.P.K. dhe Shoqërisë së Përthithur GREEN COAST 2 SH.P.K. ;
- Shtojca F** – Raportin e Audituesit të Pavarur Venis Audit & Financë shpk (NUIS L1200500L) me datë 28.10.2020.

\*\*\*\*\*

Tiranë më, 28 Tetor 2020

GREEN COAST SH.P.K.

  
Çeljeta Apostol - Administratori i Vetëm  
  
Green Coast  
L413290380

GREEN COAST 2 SH.P.K.

  
Çeljeta Apostol - Administratori i Vetëm  
  
Green Coast 2  
L72115009L

**SHTOJCA E**

**PROJEKT-MARREVEESHJA E BASHKIMIT ME PËRTHITHJE MES SHOQËRISE PËRTHITHËSE GREEN COAST  
SH.P.K. DHE SHOQËRISË SË PËRTHITHUR GREEN COAST 2 SH.P.K**

REPUBLIKA E SHQIPËRSIË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

NR. \_\_\_\_\_ REP.

NR. \_\_\_\_\_ COL.

MARRËVESHJE BASHKIMI ME PËRTHITHJE

Sot, më \_\_\_\_\_ 2020, në Tiranë, përpara meje, \_\_\_\_\_, Noter i Dhomës së Noterëve Tiranë, paraqiten personat e mëposhtëm:

- Shoqëria GREEN COAST SH.P.K, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njësia Bashkiake nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D me kapital të regjistruar me vlerë 2,562,416,988 LEKE, përfaqësuar nga administratori Znj. Çeljeta Apostol, shtetase shqiptare, lindur më 24.04.1973, në Laç, Krujë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. BE7466969, dhe me nr. personal H35424057N;
- Shoqëria GREEN COAST 2 SH.P.K. , shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, kati 4, apartamenti 26 regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L72115009L, me kapital të regjistruar me vlerë 96,15,840 LEKE, përfaqësuar nga Administratori Znj. Çeljeta Apostol, shtetase shqiptare, lindur në Laç, në datën 23.09.1975, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. BE7466969 dhe me numër personal H35424057N;

Personat e paraqitur, për identitetin e të cilëve unë Noteri jam e sigurt, bien dakord për sa parashikuar në vijim nga ky akt

**duke parashtruar se :**

- BALFIN SH.P.K. zotëron 100% të kapitalit të GREEN COAST SH.P.K.;
- BALFIN SH.P.K. zotëron 100% të kapitalit të GREEN COAST 2 SH.P.K.;
- raporti/ projekt marrëveshja e bashkimit të shoqërive GREEN COAST SH.P.K.dhe GREEN COAST 2 SH.P.K. është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me datë \_\_\_\_\_ 2020 dhe numër ështëjeje CN-\_\_\_\_\_;
- me datë \_\_\_\_\_ 2020, shoqëritë GREEN COAST SH.P.K. dhe GREEN COAST 2 SH.P.K., me vendimet respektive të asamblesë së përgjithshme sikurse më sipërshënuar, kanë aprovuar bashkimin nëpërmjet përthithjes së shoqërive GREEN COAST SH.P.K. (në vijim "shoqëria e përthithur") nga shoqëria GREEN COAST 2 SH.P.K. (në vijim "shoqëria



- përthithëse"), duke miratuar, ndër të tjera, edhe projektin e bashkimit të publikuar dhe regjistruar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi; dhe
- tashmë, sipas nenit 216, paragrafi 3, dhe nenit 225, paragrafi 2, Ligjit nr. 9901, me datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (në vijim "Ligji Tregtar"), është e mundur të procedohet me ekzekutimin e marrëveshjes së bashkimit.

**Duke u mbështetur në këto kushte** që konsiderohen pjesë thelbësore dhe integruese e këtij akti palët bien dakord për sa më poshtë:

- 1) Shoqëritë GREEN COAST SH.P.K.dhe GREEN COAST 2 SH.P.K. deklarohen dhe konsiderohen të bashkuara nëpërmjet përthithjes së shoqërisë GREEN COAST 2 SH.P.K. nga shoqëria GREEN COAST SH.P.K. mbi bazën e vendimeve respektive të asamblesë së përgjithshme me datë \_\_\_\_\_. 2020.
- 2) Rrjedhimisht, duke u mbështetur në sa më sipër, shoqëria GREEN COAST SH.P.K. zëvendëson me të drejta të plota shoqërinë GREEN COAST 2 SH.P.K. në pasurinë e saj aktive dhe pasive, si dhe në të gjitha pretendimet, çështjet gjyqësore, të drejtat, kontratat, detyrimet dhe debitë e cilësdo natyre qofshin, duke marrë përsipër të shlyejë dhe shuajë të gjitha debitë eventualisht ekzistuese brenda afateve përkatëse.
- 3) Me anë të këtij akti, autorizohet çdo ent apo organ tjetër kompetent i administratës publike, person juridik publik apo privat që të transferojnë dhe të zëvendësojë titullaritetin në të drejta e sende dhe vendosjen e tyre në emër të shoqërisë GREEN COAST SH.P.K.. Më specifikisht autorizohet kalimi në emër të shoqërisë GREEN COAST SH.P.K. i çdo pasurie të luajtshme apo të paluajtshme, të prekshme apo të paprekshme, akti, dokumenti, garancie, police, licence, lejeje dhe kontrate e cilësdo natyre qoftë, llogari aktive apo pasive të zotëruar nga shoqëria GREEN COAST 2 SH.P.K., pa qenë e nevojshëm të lëshohen autorizime apo të kryen formalitete të mëtejshme për këtë qëllim.
- 3) Me ekzekutimin e bashkimit të shoqërive në fjalë, gjejnë zbatim të plotë vendimet e asambleve përkatëse miratuar me datë \_\_\_\_\_. 2020.
- 4) Në veçanti, sikurse rezulton nga raporti/projekt marrëveshja e bashkimit dhe vendimet e asambleve përkatëse:
  - a. nuk do të ketë ndryshime në statutit të shoqërisë përthithëse;
  - b. kapitalit i shoqërisë përthithëse do të zmadhohet me një vlerë prej 96,15,840 LEKE dhe të bëhet pas bashkimit 2,658,582,828 LEKE;
  - c. nuk është përcaktuar raporti i këmbimit të kuotave;
  - d. kuota e shoqërisë përthithëse GREEN COAST SH.P.K. nuk do të shpërndahen (caktohen) në një mënyrë të ndryshme, ndërsa kuota që përbën kapitalin themeltar të shoqërisë së përthithur GREEN COAST 2 SH.P.K. - e zotëruara tërësisht nga ortaku i vetem i shoqërisë përthithëse - do të anulohen.

5) Data nga e cila marrëveshja e bashkimit shpalos efektet e saj dhe hedhja operacioneve të shoqërive të përthithura në bilancin e shoqërisë përthithëse përcaktohet sipas parashikimeve të nenit 220, paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Tregtar. Pra, efektet e bashkimit në raport me kalimin e aktiveve dhe pasive të shoqërive të përthithura hyjnë në fuqi nga data e kryerjes së regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Ndërsa, për qëllime kontabël dhe fiskale efektet e bashkimit rrjedhin nga data \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2020, si edhe përcaktuar në projekt marrëveshjen e bashkimit.

6) Pushojnë së ekzistuari organet e shoqërisë GREEN COAST 2 SH.P.K. dhe të gjitha prokurat eventuale lëshuar në emër dhe për llogari të tyre, ndërsa organi administrativ i shoqërisë përthithëse do të qëndrojë në detyrë deri në përfundimin e afatit të caktuar.

7) Shoqëria e përthithur GREEN COAST 2 SH.P.K., autorizon në mënyrë të pakthyeshme shoqërinë përthithëse GREEN COAST SH.P.K. të kryejë çdo veprim, procedurë apo formalitet të nevojshëm dhe oportun me qëllim njohjen e saj si titullare ekskluzive të çdo aktiviteti ekonomik të shoqërisë së përthithur dhe ta zëvendësojë atë me te drejta e plota në çdo raport aktiv dhe pasiv të krijuar prej tyre.

8) Pavarësisht nga sa më sipër, GREEN COAST SH.P.K. nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjorë merr përsipër t'i japë çdo kreditori eventual që ngre pretendime, brenda afateve të përcaktuara në nenin 221 të Ligjit Tregtar, të gjitha garancitë e parashikuara në nenin 221, paragrafi 1, Ligjit Tregtar.

\*\*\*\*

Kjo Marrëveshje, pasi u hartua prej meje, Noteres, iu lexua palëve të cilat e kuptuan, aprovuan dhe e deklaruan atë në përputhje me vullnetin e tyre. Marrëveshja u nënshkrua lirisht nga palët në praninë time dhe unë, Noteri, e vërtetoj atë sipas ligjit.

GREEN COAST SH.P.K.

GREEN COAST 2 SH.P.K.

\_\_\_\_\_  
Çeljeta Apostol - Administratori i Vetëm

\_\_\_\_\_  
Çeljeta Apostol - Administratori i Vetëm

NOTER

\_\_\_\_\_

SHTOJCAF

RAPORTIN E AUDITUESIT TE PAVARUR VENIS AUDIT & FINANCË SHPK (NUIS L1200500L) ME DATE  
28.10.2020

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Për planin e bashkimit me anë të përthithjes,  
të shoqërisë "Green Coast 2" sh.p.k., nga shoqëria "Green Coast" sh.p.k.**

**Deklaratë përgjegjësie:** Ky raport bazohet në të dhënat e paraqitura në Projekt-marrëveshjen dhe në Planin e bashkimit me përthitje datë 13 Tetor 2020, përgatitur nga shoqëria "Green Coast" sh.p.k. (shoqëri përthithëse) dhe shoqëria "Green Coast 2" sh.p.k. (shoqëri e përthithur) referuar pasqyrave financiare individuale të tyre dhe në informacionet e tjera të shënuara në listën e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe në korespondencën shkresore me e-mail.



- Drejtuar:**
- SHOQËRISË "BALFIN" SH.P.K.**  
Ortak i vetëm i shoqërisë "Green Coast 2" sh.p.k. dhe "Green Coast" sh.p.k.  
Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Tiranë
  - **SHOQËRISË "GREEN COAST" SH.P.K.**  
NJ.B.Nr. 2, Rr. "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, kati 4, Ap. Nr. 31, Tiranë
  - SHOQËRISË "GREEN COAST 2" SH.P.K**  
NJ.B.Nr. 2, Rr. "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, kati 4, Ap. Nr. 26, Tiranë

## 1. Hyrje

Shoqëria e auditimit "VENIS- Audit & Financë" sh.p.k, është angazhuar nga shoqëritë e mësipërme, për të përmbushur vlerësimin e kushteve të kryerjes së transaksionit të bashkimit me përthithje të shoqërisë "Green Coast" sh.p.k. (referuar si Shoqëria Përthithëse) me shoqërinë "Green Coast 2" sh.p.k. (referuar si Shoqëria e Përthithur) dhe lëshimi i Raportit për dhënie të sigurisë së kufizuar për këtë çështje.

Shoqëria BALFIN sh.p.k. ka vendosur të fillojë procesin e riorganizimit të shoqërive të zotëruara direkt prej saj. Në këtë kontekst, meqenëse shoqëria "Green Coast" sh.p.k. dhe shoqëria "Green Coast 2" sh.p.k., zotërohen 100% nga shoqëria "BALFIN" sh.p.k., kjo e fundit ka vendosur që "Green Coast" sh.p.k. të përthithë shoqërinë "Green Coast 2" sh.p.k.. Shoqëria Përthithëse do të vijojë të jetë 100% në pronësi direkte të saj.

Ky raport lëshohet në përputhje me nenin 217 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014, Tetor 2014 dhe me Standartet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (ISAE 3000), në lidhje me planin e bashkimit me përthithje të:

- **Shoqërisë "Green Coast 2" sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë së Përthithur**, një shoqëri ekzistuese, e krijuar në baze të ligjeve shqiptare dhe regjistruar ne regjistrin tregtar me datë 15/09/2017, me NUIS L72115009L, me kapital të regjistruar me vlerë 96,165,840 Lekë, me seli në Njesia Bashkiake nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr.26, Tiranë;
- **Nga shoqëria "GREEN COAST" sh.p.k., në cilësinë e shoqërisë Përthithëse**, një shoqëri ekzistuese e krijuar në baze të ligjeve shqiptare dhe regjistruar ne regjistrin tregtar me datë 29/01/2014, e regjistruar në administratën shtetërore me NUIS L41329038D, me kapital të regjistruar me vlerë 2,562,416,988 Lekë, me seli në Njesia Bashkiake nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr.31, Tiranë (referuar më poshtë si shoqëria përthithëse).

Në përfundim të procesit të bashkimit kapitali i shoqërisë përthithëse "GREEN COAST" sh.p.k., sikurse edhe me pare, do të zotërohet drejtperdrejt nga shoqëria BALFIN sh.p.k., në vlerën e investuar prej saj, në të dy shoqëritë.

## 2. Përshkrimi i përgjithshëm i transaksionit

Projekt marreveshja e bashkimit parashikon se do të ketë, në pajtim me nenet 214-224 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Bashkim me Përthithje të shoqërisë tregtare "Green Coast 2" sh.p.k."shoqëri e përthithur", nga ana e shoqërisë "Green Coast" sh.p.k. "shoqëri përthithëse", referuar vendimit të Asamblesë së Ortakut të vetëm të marrë për këtë qëllim.

Në projekt marreveshje është përcaktuar data 31.08.2020, si datë duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë që përthithet do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë përthithëse.

Si datë e hyrjes në fuqi e bashkimit do të konsiderohet data e regjistrimit përfundimtar të bashkimit nga shoqëria përthithëse në Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila bëhet e mundur pas marrjes së miratimit nga Autoriteti i

Konkurrencës, i njoftimit të administratës tatimore (e cila mund të kryej procedura verifikimi ose jo), si edhe e plotësimit të kërkesave të tjera të përcaktuara në ligj.

Bashkimi është propozuar për të rritur efikasitetin e përdorimit të burimeve dhe kursimin e kostove, për të lehtësuar ekzekutimin e veprimeve të biznesit dhe rritjen e konkureshmërisë, me qëllim final rritjen e të ardhurave dhe të fitimit të ortakut.

### **3. Përshkrimi i Planit të Bashkimit, Metoda e Vlerësimit dhe Raporti i Këmbimit**

#### **a) Përshkrimi i planit për bashkim**

Në datën që do të vendoset në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të vetëm, shoqëria e përthithur "Green Coast 2" sh.p.k. do të transferojë të gjitha aktivet, detyrimet dhe kapitalin e saj me vlerat referuar pasqyrave financiare të raportuara sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të datës 31 Gusht 2020 dhe ndryshimeve deri në datën e përfundimit të procesit të përthithjes. Aktivet dhe detyrimet e shoqërive pjesëmarrëse në bashkim me datë 31.08.2020 dhe me 31.12.2019 janë paraqitur në Planin e Bashkimit (projekt marrëveshja) që ndodhet bashkëlidhur. Aktivet dhe pasivet përfshijnë cdo të drejtë dhe detyrim të njohur si të tillë në pasqyrat financiare të "Green Coast 2" sh.p.k., të cilat përbehen nga elementët e mëposhtëm: mjetet monetare në arkë dhe në bankë, listën klientëve, të furnitoreve, të drejtat dhe detyrimet tatimore, të drejtat dhe detyrimet ndaj ortakut, aktivet afatgjata materiale (AAM), parapagimet për shërbime si dhe aktive të tjera.

Në mënyrë të vecantë theksojmë që në datën e këtij raporti, shoqëria e përthithur nuk ka detyrime tatimore të paguara, por nga ana tjetër, ajo do të transferojë të drejta tatimore për Tatim Fitimi dhe për TVSH, në vlerat sipas pasqyrave financiare të mbylljes, në zbatim të nenit 45 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 45 të Udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008, të dalë në zbatim të ligjit. Këto vlera janë subjekt i vlerësimit nga administrata tatimore, si pjesë e kontrolleve që mund të ushtrohen nga ana e saj para apo pas bashkimit të shoqërive.

#### **b) Metoda e Vlerësimit dhe Raporti i këmbimit**

Përfaqësuesit ligjore të shoqërive që bashkohen kanë rënë dakord dhe kanë përshkruar së bashku në Planin e Bashkimit me përthithje, faktorët e mjedisit ekonomik që e bënë të nevojshëm këtë proces bashkimi, metodën e ndjekur dhe prezantuar si më efektive nga pikëpamja e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të administrohet për të finalizuar këtë proces sa me shpejt dhe në përfitim të të gjitha palëve të përfshira në të.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përthithëse "Green Coast" sh.p.k. përbëhet nga 1 kuotë me vlerë 2,562,416,988 Lekë dhe zotërohet nga ortaku i vetëm shoqëria "BALFIN" sh.p.k..

Kapitali i shoqërisë që do të përthithet "Green Coast 2" sh.p.k. përbëhet nga 1 kuotë me vlerë 96,165,840 Lekë dhe zotërohet 100% nga ortaku i vetëm shoqëria "BALFIN" sh.p.k.

Referuar kësaj mardhënie të pronësisë së kapitalit, shoqëria përthithëse dhe shoqëria e përthithur, konsiderohen si shoqëri të kontrolluara drejtpërdrejt nga shoqëria "BALFIN" sh.p.k., e cila ka dhënë miratimin për prishjen pa likuidim të shoqërisë "Green Coast 2" sh.p.k., dhe investimin që ajo ka kryer më parë në këtë shoqëri, ta njohë dhe tranferojë në formën e zmadhimit të kapitalit tek shoqëria "Green Coast" sh.p.k..

Shoqëria "Green Coast 2" sh.p.k. transferon të gjitha të drejtat, detyrimet dhe kapitalin, sipas pasqyrave financiare të datës 31.08.2020, tek shoqëria "Green Coast" sh.p.k. duke ia kaluar të drejtat dhe përgjegjësitë ndaj palëve të treta, shoqërisë përthithëse. Si pjesë e kompletimit të procesit të përthithjes "Green Coast" sh.p.k. do të zmadhojë kapitalin ekzistues të saj për shumën 96,165,840 Lekë. Si rrjedhim vlera e kapitalit nga 2,562,416,988 Lekë që ishte para përthithjes, bëhet 2,658,582,828 Lekë, aq sa është vlera e investuar nga "BALFIN" sh.p.k. në kapitalin ekzistues të dy shoqërive, pjesë e këtij procesi. Në përfundim të procesit të bashkimit do të ketë ndryshim në vlerën absolute të kapitalit, por nuk do të ketë ndryshim në pronësinë e kapitalit të shoqërisë përthithëse "Green Coast" sh.p.k., e cila mbetet e njejte, si përpara përthithjes.





Në përputhje me natyrën e transaksionit dhe në kushtet që shoqëria "Green Coast" Sh.p.k. dhe shoqëria "Green Coast 2" sh.p.k. janë shoqëri të kontrolluara nga "BALFIN" sh.p.k. e cila zotëron direkt 100% të kapitalit të këtyre shoqërive, nuk është e zbatueshme dispozita për për kalkulimin e raportit të këmbimit të kuotave të shoqërive të përfshira në bashkim, me qëllim pagimin e ortakëve të shoqërisë që përthithet, pasi shoqërisë "BALFIN" sh.p.k. i përket efektivisht e gjithë pasuria e këtyre shoqërive para dhe pas bashkimit. Në këto rrethana, bashkimi i shoqërive të kontrolluara nga i njëjti ortak, nuk është një kombinim biznesi, ndaj si rrjedhim nuk kërkon të përcaktohet një raport specifik këmbimi, pasi shoqëria mëmë dhe njësia e kontrolluara prej saj, përbënin një njësi të vetme ekonomike edhe para se ato të bashkoheshin ligjërisht. Tabela e mëposhtme përmbledh efektet e bashkimit, mbi kontributin në kapital për tu regjistruar dhe transferuar nga ortaku i "Green Coast 2" si vijon:

Nr.	Kapitali i "Green Coast 2" sh.p.k.	Kapitali i "Green Coast 2" sh.p.k. (në Lekë)	Raporti këmbimit	Kapitali transferohet tek "Green Coast" sh.p.k. (në Lekë)
1	Ortak 100% shoqëria "BALFIN" sh.p.k.	96,165,840	1	96,165,840

Në tabelën në vijim është paraqitur informacioni për kapitalin e shoqërisë "Green Coast" sh.p.k., ashtu sikurse duhet të regjistrohet në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përmbyllje të procesit të përthithjes.

Kapitali ekzistues i shoqërisë "GREEN COAST" sh.p.k., si rezultat i procesit të bashkimit me përthithje, do të zmadhohet për shumën 96,165,840 Lekë, që përfaqëson kapitalin e investuar më parë nga shoqëria "BALFIN" sh.p.k. në kapitalin e shoqërisë "Green Coast 2" sh.p.k. Kapitali i shoqërisë "GREEN COAST" sh.p.k., do të përbëhet nga 1 (një) kuotë, në pronësi 100% të ortakut të vetëm, shoqërisë "BALFIN" sh.p.k., me vlerë nominale të kontributit prej 2,658,582,828 (Dy miliard e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet e tetë) Lekë, sikurse është paraqitur më poshtë:

Nr.	Kapitali i "GREEN COAST" sh.p.k.	ISHTE Para bashkimit me përthithje (në Lekë)	Zmadhimi i kapitalit nga procesi i bashkimit (në Lekë)	BËHET Pas bashkimit me përthithje (në Lekë)
1	Ortak 100% shoqëria "Balfin" sh.p.k.	2,562,416,988	96,165,840	2,658,582,828
	Numri i kuotave	1		1

Ortaku i vetëm vazhdon të gëzojë të njëjtat të drejta sikurse i kishte përpara zmadhimin të kapitalit. Që nga data 31.08.2020 të gjitha aktivet dhe detyrimet gjenden në "Green Coast 2" sh.p.k. do të konsiderohen aktive dhe detyrime të "Green Coast" sh.p.k. Pas bashkimit, shoqëria "Green Coast" sh.p.k., do të jetë e vetmja palë përgjegjëse, ku punonjësit, administrata tatimore, kreditorët, e të tjerë palë të interesuara, do të mund të drejtojnë të gjitha pretendimet e papërbushura (nëse ka), të tashme e në të ardhmen.

#### 4. Puna e kryer dhe opinioni

Në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, përshkrimi i planit të bashkimit dhe i metodës së vlerësimit të bashkimit me përthithje si dhe përcaktimi i raportit të këmbimit janë përgjegjësi e përfaqësuesve ligjorë të këtyre kompanive.

Përgjegjësia jonë, bazuar në punën e kryer, është për të nxjerrë një raport mbi përshtatshmërinë e metodës së vlerësimit të përdorur dhe rëndësinë relative që i jepet një metodë të tillë në përcaktimin e vlerës së pasurisë së shoqërive pjesëmarrëse në proces, po kështu korrektesinë dhe arsyeshmërinë në të cilën rezulton raporti i këmbimit të kuotave të kapitalit.

Angazhimi ynë është ndërmarrë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (ISAE 3000). Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë rishikimin tonë për të marrë siguri të moderuar nëse metoda e vlerësimit dhe raporti i këmbimit të aksioneve të propozuara janë pa gabime materiale. Ne nuk kemi kryer një auditim dhe në përputhje me rrethanat, ne nuk shprehim një opinion të auditimit.

Më konkretisht, në kontekstin e punës, ne kemi kryer procedurat e mëposhtme:

- a). Analizën e planit për bashkim dhe të raporteve përkatëse pasurisë të "Green Coast" sh.p.k. dhe "Green Coast 2" sh.p.k. të përfshira në Planin e Bashkimit, referuar datës raportuese 31.08.2020;
- b). Metoda e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të transferuara dhe procedurat e parashikuara nga shoqëritë për këtë proces;
- c). Shqyrtim i vlerës së ndryshuar të kapitalit pas bashkimit.

Bazuar në punën e kryer, nuk erdhi në vëmendjen tonë ndonjë çështje që ne të besojmë që:

- Mosaplikimi i raportit të këmbimit të kuotave, për shkak të ekzistencës së mardhenieve të pronësisë së plotë të kapitalit të shoqërisë "BALFIN" sh.p.k. mbi shoqërinë e përthithur dhe atë përthithëse, sikurse janë përshkruar më sipër dhe paraqitur në planin e bashkimit, nuk është i përshtatshëm dhe i arsyeshëm;
- Metoda e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të transferuara, nuk është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për rrethanat;
- Vlera e kapitalit të shoqërisë përthithëse "Green Coast" sh.p.k. e cila do të zmadhohet për shumën 96,165,840 Lekë, si rezultat i bashkimit me përthithje të ketyre dy shoqërive, duke e ndryshuar vlerën nga 2,562,416,988 Lekë në 2,658,582,828 Lekë, në pronësi 100% të shoqërisë "BALFIN" sh.p.k., zotëruese e vetme e kuotës së kapitalit të kësaj shoqërie si edhe përpara këtij procesi, të mos jetë e përshtatshme.

Venis-Audit & Financë sh.p.k.

Vera Lala  
Administrator



Tiranë, më 28 Tetor 2020

Vera Lala  
Auditues Ligjor

*Green Coast Sh.p.k*  
Rr "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3,  
Kati 4, Apartamenti nr. 31 Tiranë  
NUIIS: L41329038D

Tiranë, më 29.07.2020

### AUTORIZIM PËRFAQËSIMI

Sot, më datë 29.07.2020, unë, e nënshkruara Znj. Çeljeta Apostol, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, në datën 24/04/1973, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. BE7466969 dhe me numër personal H35424057N, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e administratores së Shoqërisë "Green Coast " Sh.p.k. ("SHOQËRIA"), nëpërmjet këtij autorizimi, emëroj si vijon:

**ZNJ. Rozana Kodrari**, shtetase shqiptare, lindur në Shkodër, më 18.10.1990, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.J06018088B, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

*si përfaqësuese për të kryer veprimet sa më poshtë:*

Të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, aplikimet dhe të nënshkruajë të gjithë praktiken/ formularët për regjistrimin e vendimeve apo çfarëdo lloj akti tjetër të Shoqërisë, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), të plotësojë dhe të nënshkruajë të gjithë formularët e nevojshëm para sporteleve të QKB-së me qëllim regjistrimin e tyre

*"Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesja në këtë autorizim do të konsiderohen të drejta dhe të vlefshme njëllor sikur të ishin kryer nga unë personalisht".*

#### I PËRFAQËSUARI

Shoqëria "Green Coast " Sh.p.k

*Çeljeta Apostol*

Çeljeta Apostol

